



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2
Dhjetor 2024

110 VITE NGA MIRATIMI I STATUTIT ORGANIK KUSHTETUTA E PARË E SHQIPËRISË

Ndriçim Mehmeti*, Nevila Mehmeti**

*Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Fakulteti i Shkencave Shoqërore,
Albanian University, Tiranë

** Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi nuk është thjesht rastësia me 110 vjetorin e Statutit Organizim të Shqipërisë, i cili gjërësisht quhet si kushtetutat e parë e Shqipërisë, prej shpalljes së Pavarësisë. Ky punim përmes metodës së hulumtimit, do të hedh një vështrim mbi rethanat historike në të cilat u hartua statuti, të nxjerrë në pah krijimin e një traditë shtetfotmuese, të vendosur mbi baza kushtetuese, të shtetit të ri shqiptar duke shprehur më së shumti nga vullnetin e gjashtë Fuqive të Mëdha të kohës dhe Komisionit Ndërkombëtar i Kontrollit, në përputhje me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, të shpallura më 29 korrik 1913. Statuti Organik shënon një ngjarje të veçantë në historinë e Shqipërisë pasi për herë të parë kemi një ligj themeltar të hartuar për vendin tonë. Statuti Organik, i miratuar në prill 1914, përbëhet nga 17 kapituj dhe 216 nene, ku trajtohen disa nga problemet kryesore si forma e qeverisjes, pozita ndërkombëtare e Shqipërisë dhe territori i saj, pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, popullsia, të drejtat dhe detyrat e saj, forcat e armatosura, organet e drejtësisë etj.

Synimi i këtij punimi është të nxjerr në pah veçoritë e këtij statute si dhe mënyrën e organizimit të shtetit shqiptar sipas diaspazitave të këtij statute. Përmes diskutimit të problematikave të asaj periudhe do të arrijmë në përfundim të rëndësishëm të Statutit për kontekstin historik në të cilin u miratua.

Fjalë çelës: Statuti Organik, Kushtetuta, Shqipëri, Fuqitë e Mëdha, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit

110TH ANNIVERSARY OF THE ORGANIC STATUTE OF ALBANIA

Abstract

The purpose of this paper is not simply the coincidence with the 110th anniversary of the Organizational Statute of Albania, which is widely referred to as the first constitutions of Albania, since the

declaration of Independence. This paper, through the research method, will take a look at the historical circumstances in which the statute was drawn up, highlighting the creation of a state-making tradition, established on the constitutional basis, of the new Albanian state, mostly based on the will of the six Great Powers of the time and the International Control Commission, in accordance with the decisions of the Conference of Ambassadors in London, announced on July 29, 1913. The Organic Statute marks a special event in the history of Albania as for the first time we have a law founders drafted for our country. The Organic Statute, approved in April 1914, consisted of 17 chapters and 216 articles, which dealt with some of the main problems such as the form of government, the international position of Albania and its territory, the legislative and executive power, the population, its rights and duties, armed forces, justice bodies, etc.

The aim of this paper is to highlight the features of this statute as well as the way the Albanian state is organized according to the provisions of this statute. Through the discussion of the problems of that period, we will reach conclusions about the importance of the Statute for the historical context in which it was adopted.

Key words: *Organic Statute, Constitution, Albania, Great Powers, International Control Commission*

Hyrje

Ky punim sjell në vëmendje ngjarje të rëndësime historiko-juridike, që ka të bëjë me aftësinë shtetformuese dhe themmelet juridike të një shtetit, sikundër është miratimi i Statutit Organik të vitit 1914. Konteksti historik i punimit bën fjalë për ngjarjet e vitit 1914, kur paqja në Evropë ishte gjithnjë e më e brishtë, si shkak i rivaliteteve që qëndronin pezull gati për shpërthim. Gjithsesi Fuqitë e Mëdha, kishin siguruar njëfarë mirëkuptimi, në rastin e Shqipërisë, duke marrë disa vendime shumë të rëndësishme në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, e cila, zhvilloi punimet e saj nga dhjetori 1912 – gusht 1913. Në vendimet e saj Konferenca e Ambasadorëve kishte paracaktuar për Shqipërinë një formë regjimi monarkik, i cili do të kryesohej nga një princ i zgjedhur prej vetë Fuqive të Mëdha. “Mbas kësaj ngjarjeje, Kryetari i qeverisë provizore Ismail Qemali më 24 Kallnuer (janar) 1914 dhe dorëheqjen dhe u nis për Itali, duke ja dorëzuar qeverin komisionit internacional të kontrollit”¹ Ndërkohë që Fuqitë e Mëdha kishin rënë dakord për një kandidaturë të një Princi gjerman, të quajtur Wilhelm Von Wied. Në këtë grup kandidaturash të shpallura apo të vetë-shpallura, më i përshtatshëm për fronin mbretëror ishte një emër jo shumë i dëgjuar, por i veshur me petkun e bekimit të Fuqive të Mëdha. Ky ishte Vilhelm fon Vid. “Vidi u lind më 26 mars 1876, ishte biri i dytë i princit Vilhelm dhe i së shoqes Maria, princesha e Holandës. Më 1892-1896 vajti në gjimnaz të Vjenës. Më 1896 hyri në ushtri, përgatiti provimet për oficer që i mori me shumë lavdërimi më 1899. Më 20 mars të vitit 1901 emërohet kapiten i kalorësisë. Më 1906 martohet me princeshën Sofia dhe kishte dy fëmijë Maria Eleonora dhe Karol Viktor.”² Njeriu që do të merrte përsipër të udhëhiqte Shqipërinë, pritej të vinte në vend rendin, stabilitetin dhe ligjin në shtetin më të ri në Ballkan, dhe me më shumë probleme se çdo vend tjetër. Po pse pikërisht Vidi në Shqipëri përkundër shumë kandidaturave të tjera të përshkruara më lart? Ai ishte kandidatura e përbashkët e Austro-Hungarisë dhe Italisë, por në të njëjtën kohë, kishte mbështetjen edhe të fuqive të tjera. Në fakt Vidit vetë, kur i propozuan fronin e Shqipërisë nuk qe shumë entuziast.

Në kujtimet e veta ai shkruan: “Kur me propozim të Austro-Hungarisë dhe Italisë Fuqitë e Mëdha më zgjodhën mua si sovran të Shqipërisë, në fillim e refuzova. Unë i njihja mirë e bukur

1 T.Selenica, Shqipëria më 1927, Tiranë, 1928, fq. 35

2 A.Q.Sh. F.84, D.64. fq. 16.

*vështirësitë kolosale që i viheshin princit të këtij vendi.*³” Një ndërmarrje kaq serioze nuk mund të thuhet se ka trembur oficerin gjerman porse ky i fundit siç shprehej edhe vetë “*kërkonte më shumë garanci.*”⁴ Me të drejtë, monarku i ardhshëm shqiptar me të drejtë kishte disa kushte për të ardhur në Shqipëri. “*Princi me mençuri nuk pranoi të shkonte në Shqipëri deria të sqarohej situata politike; derisa fuiqtë të garantonin një hua prej 3.000.000 stërlinash dhe derisa populli shqiptar të jepte miratimin. Kushti i fundit u plotësua menjëherë me formalitetin e një votimi*”⁵

Kushtet historike në të cilat u miratua Statuti Organik dhe rëndësia e tij

Princi përgatitej të vinte në një vend ku shumëçka, i ishte nënshtruar interesave të çastit pa njohur asnjë kod rregullash dhe parimesh. Vendi i nënshtetasve të ardhshëm të Vid-it ishte i përçarë politikisht dhe me një unitet territorial të cunguar. Pavarësisht, kësaj situatë të zymtë, brenda vendit Princi gëzonte një mbështetje të gjerë. K.N.K. ishte caktuar të përgatiste terrenin për ardhjen e tij dhe të hartonte ligjet mbi bazën e së cilës do të mbështetej qeverisja e Vidit. Pas ardhjes së Princit dhe zgjedhjes prej tij të kabinetit qeveritar, detyra parësore e Komisioni Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK), ishte formimi i një kuadri ligjor, për të mbështetur qeverisjen e re të vendit. Vendi kishte nevojë për një orgaznimi në nivel qëndror dhe lokal, vendosjen e disa rregullave por padyshim edhe jetësimin në pikëpamje ligjore të vendimeve që ishin marrë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, prej Fuqive të Mëdha në periudhën korrik-gusht 1913. Kjo detyrë u realizua me shpalljen më 10 prill 1914, të Statusit Organik të Shqipërisë. Përtej analizës juridiko-politike që mund t’i bëhet këtij dokumenti ligjor, bie në sy që në fillim, se ai është i pari në llojin e vet, i njohur dhe i miratuar ndërkombëtarisht. Ai ka një rëndësi të veçantë për faktin, se për të parën herë Shqipëria sanksiononte organizimin e vendit, pozitën juridiko-ndërkombëtare, ndarjen administrative etj, rolin që kishin tre pushtete: Ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, kush i përfaqësonte etj. Duke pasur parasysh një studim të prof. A. Puto mund të sjellim në vëmendjen tonë disa nga konstatimet e tij, në lidhje me përmbajtjen e Statutit Organik. “*Në rradhë të parë ai është një ligj themeltar, një kushtetutë e shtetit të ri shqiptar; pra një akt i brendshëm. Por nga ana tjetër në një pikëpamje ai është një akt ndërkombëtar, në dy kuptime:*

a-Në një kuptim të gjerë sepse ai është produkt i diplomacisë së Fuqive;

*b-Në një kuptim më të ngushtë, veç disa dispozitave që i përkasin të drejtës së brendshme, statuti trajton një sërë problemesh me karakter ndërkombëtar.*⁶ Statuti tërheq vëmendjen jo vetëm për sa i përket formës së tij, por edhe përmbajtjes, ku të bie në sy pozita e veçantë që i jep ai Princit. “*Prerogativat e tij janë të gjera (Kap.II i Statusit).*

Princi shpallet “kryetar i administratës civile dhe ushtarake” ai “thërret, mbyll dhe shpërndan Asamblenë Kombëtare, drejtësia jepet në emër të tij”, “*të gjithë ministrat emërohen prej tij, ai përfundon traktatet ndërkombëtare.*”⁷ Kompetencat e gjera që i jepeshin Princit i vinin përshtat dëshirës së tij për një pushtet autoritar të moderuar. Mbase Williams ka pasur parasysh këtë fakt kur shprehet për Statusin se: “*Asnjë lloj kushtetutë nuk u ofrua për të patur miratimin e qytetarëve, asnjë fjalë për garancitë e lirisë dhe të drejtat e tyre të hershme.*”⁸ Diplomati amerikan i edukuar me frymën e Xhefersonit dhe Franklini nuk mund ta konceptonte realitetin shqiptar dhe për pasojë të drejtën kushtetuese të aprovuar në atë kohë. Edhe sikur, të ishte një kushtetutë e tillë, përfytyruar nga ambasadori amerikan, vështirë se në Shqipërinë e asaj kohe, gjeje një botëkuptim të qartë për detyrat dhe të drejtat e

3 Arkivi Austro-Hungarez. A.I.H. A-66 ,Kujtime, Vilhelm von Vid, fq.10

4 A.I.H. A-66 ,burim i cituar fq.10

5 J. Swire, Shqipëria, ngritja e një mbretërie, Tiranë, 2005, fq.158.

6 A Puto., “Historia diplomatike e çështjes shqiptare”1876-1926.Tiranë 2003, fq.199

7 A.Puto.,vepër e cituar fq.200-201.

8 D.H. Armstrong . “Gjashtë muaj Mbretëri”,Tiranë 1995fq.30

qytetarëve në një sistem liberal.

Pavarësisht kësaj kritike të rreptë të Williams, Statuti linte vend për terma të demokracisë dhe të drejtave. “Në statut nuk mungojnë as disa koncepte të demokracisë; ato gjejnë shprehje sado të zbehtë, në kapitujt kushtuar popullsisë, Asamblesë Kombëtare, administratës lokale.⁹” Në tërësinë e vet Statuti mbështetej mbi vendimet e marra nga Konferenca e Ambasadorëve e Londrës të 29 korrikut 1913. Statuti rikonfirmonte pozitën e Shqipërisë “si një shtet i pavarur, pra si një palë më vete në marrëdhëniet ndërkombëtare.¹⁰” Pra Shqipëria konsiderohej tashmë si një vend i pavarur, me një sovran të vetin dhe qeveri të ligjshme, e aftë për të marrë vendime brenda vendit dhe për të operuar si e barabartë në marrëdhëniet me shtete të tjera. Sakaq kjo dispozitë pasohej edhe nga akte të tjera ndërkombëtare që realisht kufizonin atributet e një qeverie shqiptare tërësisht të pavarur. Gjithsesi për tu ndalur tek Statuti, i cili, përcaktonte një formulë disi të komplikuar të përbërjes së Asamblesë Kombëtare, që përfaqësonte pushtetin legjislativ. “Asambleja Kombëtare do të përbëhej prej anëtarësh të zgjedhur me vota të tërthorta, nga tre përfaqësues për çdo prefekturë. Në të do të bënin pjesë përfaqësues të komuniteteve fetare, Komisiari i lartë në “Bankën Kombëtare Shqiptare” dhe dhjetë anëtarë të caktuar nga Princi”.¹¹

Sa i takon organizimit të brendshëm të vendit, Statuti, përcaktonte se “Shqipëria ndahej në shtatë prefektura: Shkodër, Elbasan, Dibër, Durrës, Berta, Korçë e Gjirokastrë”¹² Në aspektin ndërkombëtar, K.N.K.u kujdes që në Statut të kishte një dispozitë të veçantë, e cila, riafirmonte Kapitulationet (privilegjet dhe imuniteti i shtetasve evropian) e Fuqive në Shqipëri, të njohura që prej faktit kur ishte nën Perandorinë Osmane. Kjo dispozitë do ti hapte telashe të mëdha Wied-it më pas, veçanërisht në tri raste: Në rastin e arrestimit të Esatit, çështja e dyshimit për tradhti të kolonelit italian Murrichio dhe të dëbimit nga vendi të Gjuraskoviç, ish-prefekt i Durrësit në kohën e pushtimit serb. Në vijim të jetësimit të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, ku Fuqitë e Mëdha, garantonin tërësinë territoriale të Principatës shqiptare dhe neutralitetin e saj, u pa e nevojshme të ishte e sanksionuar edhe në Statut. Është e rëndësishme të theksohet se kjo dispozitë “riprodhohet në Kushtetutën e shtetit shqiptar”.¹³

Faktorët që penguan zbatimin në terren të Statutit

Në tërësi, K.N.K hartoi një statut që i përshtatej zhvillimit, ekonomik, politik dhe të Shqipërisë, në atë periudhë. Dilema më e madhe, (siç ndodh në jo pak raste edhe sot pas 110 vjetësh) ishte se si do të zbatohet. Kjo nuk varej shumë nga vullneti i qeverisë, së Wied-it apo mbështetësve të qeverisë, porse nga disa faktorë për zbatimin e tij. Në një territor ku Wied-i dhe qeveria nuk ushtronin plotësisht pushtetin e tyre, zor se mund të flitet për një qeverisje efikase. Gjithsesi hartimi dhe miratimi i një ligjit themeltar për Shqipërinë, i cili, njihet me emrin Shtatuti Organik, në atë periudhë, ishte një arritje e rëndësishme. I hartuar nga përfaqësues të gjashtë Fuqive të Mëdha, u mendua se organizimi i tyre i quajtur KNK, do të mund të mbështeste edhe më tej në zbatimin e këtij Statuti por edhe në këshillimin apo më mirë në bashkërendimin e punës së saj me qeverinë dhe Princin. Nisur nga ky argumentim lind vetvetiu pyetja: A mund ta ndihmonte më shumë K.N.K, në këtë drejtim? Mbase në planin e brendshëm, jo aq shumë, por në atë të jashtëm mundësitë e këtij organizmi ishin më të shumta.

Pas hartimit të Statutit, K.N.K., në mënyrë të çuditshme, u tërhoq në Vlorë. Largimin e K.N.K në Vlorë Williams e konsideron “gabim të rëndë që Princi lejoi K.N.K. të vendoset në Vlorë dhe vetë

9 A. Puto, vepër e cituar fq 200.

10 A. Puto, vepër e cituar fq.202

11 Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2007, fq 59

12 Historia e Popullit Shqiptar, vepër e cituar, fq. 59

13 A. Puto., vepër e cituar fq.205.

qëndroi në Durrës, duke e mënjeluar K.N.K. nga problemet e Shqipërisë.¹⁴ Ndërsa F. Salleo vlerëson se “Vied-i e nisi mbretërimin e tij me një vendim jo fort të suksesshëm. Me t’u formuar Qeveria e ridërgoi në Vlorë K.N.K. Ky komision mund të ishte një aleat i mirë pranë Kryeqyteteve të Evropës.¹⁵” Vendimi i Princit, duket tejet i çuditshëm, po të kemi në konsideratë faktin se, “një tipar i veçantë i vendosur më Statutin Organik, është pozita e pandryshuar e KNK, që do të vazhdonte të kryente mbikqyrjen në shtetin e ri, sipas afatit të Konferencës së Londrës për 10 vjet”¹⁶ Pavarësisht kësaj, të hollat e premtuara, aq shumë të nevojshme në atë situatë, nuk po mbërrinin, premtimi për ngritjen e një banke kombëtare mbeti në letër dhe mbështetja ushtarake u harrua. Për të zbatuar statusin e aq më tepër për të shtrirë në gjithë Shqipërinë, autoritetin e qeverisë dhe Princit, (duke marrë në konsideratë se vinim pas dy luftarve ballkanike), padyshim që duhej një forcë e armatosur mirë, me autoritet dhe me detyra të qarta, që statusi ja njihte, por që mjerisht nuk u zbatuan. A ishte kjo vetëm paaftësi e Princit dhe qeverisë së Durrësit, pao edhe indiferencë e Fuqive të Mëdha, për Shqipërinë? Faktet flasin se evropianët parapëlqyen të ndjekin një politikë me dy standarde në vendin tonë, që sigurusht la një shije jo të mirë. Nëse evropianët do të sihin të vendisur do të vepronin njësoj si në rastin e Shkodrës, ashtu edhe për territorin tjetër të Shqipërisë. “Fuqitë e Mëdha i dhanë Shqipërisë dy qeveri ndërkombëtare. Njëra me forca të shumta ushtarake dhe me pushtet të kufizuar dhe tjetra me pushtet të gjerë por pa forca.”¹⁷ Ndërkaq për Wied-in ndoshta ishte koha që të merrte situatën në dorë, për të ushtruar më shumë presion në planin e brendshëm dhe në planin ndërkombëtar. Mundësitë që sovranit shqiptar të tregonte veten në qeverisjen e vendit u kufizuan gjithnjë e më tepër. Mund të thuhet me siguri se ajo që dëmtoi më shumë, qeverisjen e Princit ka qenë qëndrimi i Fuqive evropiane. Në planin qeverisës Fuqitë e Mëdha, vepruan shumë pak për të siguruar një pushtet ekzekutiv dhe gjyqësor të efektshëm në Shqipëri. Shumica e strukturave të krijuara në Shqipëri ose ishin të varura nga të huajt ose ishin nën ndikimin e Fuqive të Mëdha. Mes këtyre strukturave, mungoi një vizion dhe koordinim i qartë për qeverisjen. Brenda një kohe të shkurtër, evropianët zbatuan në Shqipëri dy modele: Administrimi ndërkombëtar i Shkodrës i mbështetur në forca ushtarake të mjaftueshme; si dhe qeverisja e Wied-it, të cilit ju premtua një territor i gjerë, por pa kurrëfarë garancie ushtarake. Pa siguri territoriale, as që mund të bëhej fjalë për reforma ekonomike dhe për një qeverisje të fortë brenda vendit. Lufta për zonat e ndikimit, modifikimi i vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, qëndrimet e lëkundura për të ardhmen e Shqipërisë, shtuan pasigurinë e sovranit evropian. Që pas caktimit të Princit, Fuqitë e Mëdha realisht e lanë fatin e Shqipërisë, në duart e Italisë dhe Austro-Hungarisë. Gjermania, Franca, Rusia dhe Anglia u mjaftuan vetëm me deklarata mbështetëse dhe raportimet që merrnin nga diplomatët e tyre në Durrës.

Në rolin e një këshilluesi që shumë pak morën përsipër për zgjidhje reale, ato nuk bënë gjë tjetër veçse provuan së bashku të bëheshin dëshmitarë të dështimit të tyre. Gjithsesi Shqipëria në ato vite, së paku, pati mbështetjen e Fuqive Evropiane, të cilat të paktën në letër por edhe në realitet provuan t’i jepnin legjitimitet shtetit të ri shqiptar.

Përfundime

Në kushte të vështira historike, pas shpalljes së Pavarësisë, që erdhi si një proces i vështirë, i brendshëm dhe i jashtëm, situatës ndërkombëtare në shpërthim e sipër, Fuqitë e Mëdha, së bashku me faktorin vendas me peshë politike e ndikim shoqëror, provuan të ndërtonin një formacion shtetëror, që mund t’i hapte rrugë shtetit modern shqiptar. Sa dhe si u arrit ky synim, mbetet një diskutim i hapur në këndvështrimin e kontekstit historik në të cilën u zhvilluan ngjarjet dhe qëndrimet që duhet mbajtur ndaj tyre. Sido që të jetë, duhet pranuar se u siguria një farë përvoje mbi punët e shtetit dhe u

14 F. G. Williams, “Shqiptarët”. Tiranë 2003 fq.42.

15 Salleo.F, Salleo.F, “Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri”, Tiranë 200, fq. 47.

16 Historia e Popullit Shqiptar, vepër e cituar, fq 59.

17 E. Durham, “20 vjet ngaterresa ballkanike” Tiranë 2001, fq.274

hordhën bazat kushtetuese të tij, veçanërisht me miratimin e Statutit Organik. Ky ishte edhe hapi më pozitiv për vendin tonë në atë periudhë. Nga ana tjetër, vendosja e shtetit mbi baza të mirëfillta ligjore, i hapi rrugën një tradite të re, por të rëndësishme në fushën e legjisalcionit për shtetin shqiptar. Mes dy Luftërave Botërore, në Shqipëri u hartuan dhe u miratuan ligje të tjera themeltare, siç ishte Statuti i Lushnjës (1920) Statuti i Zgjeruar i Lushnjës (1922) ai i Republikës në vitin 1925 dhe ai Mbretërisë Shqiptare në vitin 1928. Sigurisht që të gjitha ligjet themeltare të përmendura më lart, morën shumë prej Statutit Organik të vitit 1914, i cili, mbeti një model i mirë në fushën e legjislacionit shqiptar. Sot ne kemi mundësinë që jo vetëm thjesht ta kujtojmë si një ngjarje historike, miratimin e Statutit Organik të vitit 1914, por edhe të theksojmë me shumë krenari një traditë ligjore të shtetformimit shqiptar që i ka rrënjët së paku mbi 100 vjeçare.

Referenca:

Burime Arkivore

1. A.I.H. A-66. "Kujtime" Vilhelm von Vid
2. AQSH, F.84, D.64. fq. 16.

Burime të shkruara

3. Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2007.
4. F. G. Williams, "Shqiptarët". Tiranë 2003 fq.42.
5. Salleo.F, Salleo.F, "Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri", Tiranë 2001.
6. E. Durham, "20 vjet ngaterresa ballkanike" Tiranë 2001
7. A Puto., "Historia diplomatike e çështjes shqiptare" 1876-1926. Tiranë 2003
8. J. Swire, Shqipëria, ngritja e një mbretërie, Tiranë, 2005.
9. T.Selenica, Shqipëria më 1927, Tiranë, 1928